



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:110306

Datë: 06.03.2024

Numri i dokumentit: 05414745

PPP.nr.127/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit I.C. Kosovo J.S.C, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim D.L.R. L.L.C, me seli në Prishtinë, rr “...”, nr...., kundër debitorit P.O. nga Ferizaj, rr “...”, ndërtesa F., nr.... për pagesën e borgjit, kredisë, duke vendosur për prapësimin e debitorit, me datë 05.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit P.O., i ushtruar kundër urdhrin për përmbartim P.nr.215/22, të datës 12.05.2022, i lëshuar nga Përmbartuesi privat B.T. nga Ferizaj dhe **MBETET në fuqi** urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.215/22, i datës 12.05.2022.

A r s y e t i m

Me urdhrin për përmbartim P.nr.215/22, të datës 12.05.2022, Përmbartuesi privat B.T., e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga kreditori I.C. Kosovo J.S.C, kundër debitorit P.O., për pagesën e borgjit në shumë prej 1,507.43 euro, si dhe shpenzimet e përmbartimit, në bazë të kontratës së pengut të datës 06.06.2019, ose bllokimin e llogarive bankare të debitorëve dhe sekuestrimin e kolateralit të lënë peng nga debitorët.

Kundër urdhrin për përmbarim, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që ta pranoj prapësimin si të bazuar dhe ta shfuqizoj urdhrin për përmbarim.

I autorizuari i kreditorit ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit, me të cilën i ka propozuar gjykatës që prapësimi të refuzohet dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata në këtë çështje juridike të përmbarimit i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përmbarim P.nr.215/22, të datës 12.05.2022 dhe pretendimet në prapësim të debitorit dhe pas vlerësimit të pretendimeve konstatoj se prapësimi në fjalë është i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara në nenin 71, par 1, të LPP-së.

Gjykata vlerëson se urdhri mbi lejimin e përmbarimit P.nr.215/22, i datës 12.05.2022, i lëshuar nga përmbaruesi privat B.T., është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmbar shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore, ngase përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin në pajtim të plotë me dispozitat e nenit 22, par 1, nën par 1.7a, të Ligjit Nr.05/L-118, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139, për procedurën përmbarimore.

Sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim se përmbarimi është i papranueshëm për debitorin pasi që ky urdhër është nxjerrë në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të LPP-së, bazuar në nenin 71, të LPP-së, dokumenti në bazë të të cilit është marr urdhri nuk ka tiparet e përmbarueshmërisë si dhe nuk ka efekt të titullit ekzekutiv, bazuar në atë se dokumenti, kontrata interne e huas Nr...., e lidhur mes kompanisë I. dhe mua si huamarrës, në bazë të së cilës është caktuar përmbarimi nuk i plotëson kushtet ligjore për përmbarim dhe nuk mund të bëhet bazë dhe objekt i përmbarimit një kontratë e huasë e lëshuar brenda një kompanie e cila ka operuar paligjshëm në vendin tonë kur dihet se dokument i përmbarueshëm mund të jetë kontrata e lidhur tek noteri e jo ajo që lëshohet nga kompani private, gjykata këto pretendime i konsideron të pabazuara sepse nga shkresat e lëndës vërtetohet se përmbaruesi privat urdhrin për përmbarim e ka nxjerrë në bazë të marrëveshjes mbi pengun të datës 06.06.2019, e cila marrëveshje siç konstatohet nga Konfirmimi i Regjistrimit: R-..., e njëjta është e regjistruar në Zyrën për Regjistrim të Pengut, e cila marrëveshje në bazë të nenit 22, par 1, nën par 1.7a, të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Procedurën e Përmbarimit, konsiderohet dokument përmbarimor. Andaj, përmbaruesi privat urdhrin për përmbarim e ka nxjerrë në pajtim të plotë me nenin 22, par 1, nën par 1.7a, të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Procedurën e Përmbarimit.

Po ashtu, gjykata konstaton se edhe propozimi për përmbarim i kreditorit është ushtruar në pajtim të plotë me nenin 38, par 1, të LPP-së, për arsye se propozimi për përmbarim e

përmban kërkesën për përmbarim, dokumentin përmbarimor, marrëveshjen për pengun në origjinal, të dhënat e kreditorit dhe të debitorit, adresën e selisë, përkatësisht të vendbanimit të tyre, kredia që kërkohet të realizohet si dhe mjete nëpërmjet të cilit duhet të kryhet përmbarimi, objekti i përmbarimit, si dhe të dhënat tjera të cilat janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit.

Përndryshe regjistrimi i pengut sipas marrëveshjes së pengut është detyrim ligjor dhe pa regjistrim të pengut marrëveshja mbi pengun nuk mund të cilësohet si dokument përmbarues. Po ashtu nga shkresat e lëndës, gjegjësisht nga konfirmimi i regjistrimit të pengut, konstatohet se në rastin konkret konfirmimi i regjistrimit të pengut është lëshuar në pajtim të plotë me nenin 162, par 1 dhe nenit 163, par 1 dhe 2, të Ligjit Nr.03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore. Për më tepër në nenin 163, par 1 dhe 2 të ligjit të cekur më lart është përcaktuar shprehimisht se: “Regjistrimi në regjistrin e pengut është i vlefshëm për tri (3) vjet nga koha e regjistrimit. Me kalimin e afatit tri (3) vjeçar, e drejta e pengut pa posedim e humb efektin e saj ndaj personave të tretë, përveç kur vazhdohet regjistrimi ose kur pengu pa posedim shndërrohet në peng posedimor” dhe në rastin konkret siç konstatohet nga shkresat e lëndës kemi të bëjmë me vazhdimin e regjistrimit të së drejtës së pengut pa posedim”.

Andaj, gjykata duke i marr parasysh thëniet e debitorit në prapësim, thëniet e kreditorit në përgjigjen e ushtruar në prapësimin e debitorit, provat dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi që të njëjtin ta refuzoj në tërësi si të pabazuar, ndërsa urdhri për përmbarim P.nr.215/22, i datës 12.05.2022, të mbetet në fuqi.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.127/22, më datë 05.03.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.